



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A**

Jetëshkrim

Mimoza Dhëmbi – Drejtor i Përgjithshëm – Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

Zj.Mimoza Dhëmbi ka një eksperiencë të gjatë profesionale në fushën e financave publike. Ajo është Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave që nga viti 2005, ndërkohë që është pjesë e kësaj Ministrie që nga viti 1992.

Gjatë kësaj kohe ka mbajtur poste të ndryshme brenda drejtorisë së Buxhetit, por edhe në drejtorinë e thesarit si drejtor i saj në vitet 1999–2001. Që nga kjo kohë dhe aktualisht drejton procesin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit, buxhetit vendor, menaxhimit e investimeve publike, si dhe problemet që lidhen me sistemin buxhetor (zbatimin e ligjit organik të buxhetit, programimin e buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, hartimin e akteve në zbatim të ligjit vjetor të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrit të Financave, etj.)

Zj. Dhëmbi ka një eksperiencë të gjatë si anëtare e këshillit mbikëqyrës në disa kompani publike dhe si pjesëmarrëse në aktivitete ndërkombëtare, negociata me institucionet financiare ndërkombëtare (veçanërisht FMN, BB dhe BE).

Ajo ka qenë pjesë e të gjitha reformave në financat publike, që nga viti 1992. Zj.Dhëmbi mban një diplomë të Universitetit të Tiranës, Fakultetit Ekonomik, dega financë dhe ka kryer një sërë specializimesh e trajnimesh në USA, Austri, Japoni etj.